



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT ZËDHËNËSI

06.06.2016

### BASHKIA LEZHË

#### *Dëmi ekonomik i zbuluar në vlerën 22.4 milion lekë*

Kontrolli i Lartë të Shtetit, në zbatim të programit të tij të auditimit nr. 1105/1 prot, datë 04.02.2015, ka përfunduar auditimin në Bashkinë Lezhë, me objekt: “Auditimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për vitet 2013 - 2015”.

Me Vendimin nr. 42, datë 29.04.2016 të Kryetarit të KLSH-së është miratuar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe për përmirësimin e gjendjes, me shkresë nr. 1105/10, datë 30.06.2016 i janë rekomanduar Bashkisë Lezhë masa me karakter organizativ dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar në vlerën totale 22,4 milion lekë.

Gjatë auditimit u konstatuan disa shkelje dhe parregullsi të dispozitave ligjore në fuqi. Në përgjithësi këto shkelje e parregullsi, konsistojnë një sërë shkeljesh të dispozitave përkatëse ligjore e nënligjore gjatë ushtrimit të detyrës, në fushën e zbatimit të procedurave të prokurimit publik lidhur zbatimin e kontratës “*Rikualifikimi i Qendrës së Qytetit Lezhë*”.  
*Konkretisht:*

Mbikëqyrësi i punimeve të objektit “*Rikualifikimi i Qendrës së Qytetit Lezhë*”, ka raportuar për punime të cilat kanë rezultuar të pa kryera dhe për pajisje të pavendosura por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave, duke sjellë për pasojë likuidimin nga Bashkia Lezhë të punimeve të pakryera dhe pajisjeve të pavendosura, në dëm të buxhetit të njësisë të qeverisjes vendore dhe në cënim të investimit të realizuar.

Nuk ka kërkuar Certifikatat e cilësisë së materialeve, nuk ka kërkuar provat e cilësisë së betonit të përdorur, provat e rezistencës së çelikut, nuk ka ushtruar kontroll mbi realizimin e punimeve konform projektit të zbatimit dhe specifikimeve teknike.

KLSH, duke i konsideruar veprimet e kryera të **B.D.** me cilësinë e Përfaqësuesit ligjor të shoqërisë mbikëqyrëse të zbatimit të kontratës “*Rikualifikimi i Qendrës së Qytetit Lezhë*”, si veprime me pasojë të rënda për interesat e ligjshme të shtetit dhe të dënueshme sipas ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”, me shkresën nr. 1105/15, datë 30.05.2016, ka bërë kallëzim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Lezhë, për kryerjen e procedurave fiktive lidhur me zbatimin e procedurës së zbatimit të kontratës, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 22.4 milionë lekë, dhe për pasojë ka konsumuar elementët e figurës së veprave penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga nenet 248 të Kodit Penal.

V.O. Në Web-in e KLSH gjendet i plotë Vendimi nr. 42, datë 29.04.2016 në lidhje me këtë auditim.